

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Integrimi, Rama: E dashurojmë Evropën, por mos na lini në baltë! Do të ishte dështim madhor! Ambasad orja e BE: 2030 ambicie impenjative, vijoni punën! - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/konferenca-nderparlamentare-rama-e-dashurojme-be-shpresojme-mos-te-na-lini-ne-balte-do-te-ishte-deshtimi-me-i-madh-i-evropes?r=kh1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 09:06:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:01:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f fe2c5c24fb017bf4738cce7c16d8bdc77a858cb44bd7209fd3567aa7a0b5a26
TEKSTI	106817b155adfcdb5e2e60bcf026deb10f7640345fefc0903079f196ac3161aa
PAMJA	bd8e61a92c604d2d1f56bb5d388e9e7403a6deb76a2c26ef46984c390bc2646e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e7a91efe6ff556efb433d42d9d1a587f5672919bb224eeede4ced865f96b74f
E MËPARSHMJA	9e68422199724259a688a17ed5818038508a9b4c27ef9d506c291d46c272b523
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e7a91efe6ff556efb433d42d9d1a587f5672919bb224eeede4ced865f96b74f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Flash

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Grupi i hakërave iranian publikon mbi 600 numra telefonash të personelit të SHISH



Politikë

Integrimi, Rama: E dashurojmë Evropën, por mos na lini në baltë! Do të ishte dështim madhor! Ambasadorja e BE: 2030 ambicie impenjative, vijoni punën!

Kryeministri Edi Rama këmbëngul për një integrim gradual të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian, duke propozuar që të gjitha të ulen në tryezë dhe të përparojnë sipas meritës. Në Konferencën Ndërparlamentare për zgjerimin, përfaqësuesit europianë nga ana e tyre, vlerësuan përparimin e Shqipërisë, por theksuan se duhen rezultate të qëndrueshme kundër korrupsionit dhe zbatim i reformave.

■ **Schieder: Shqipëria është pararendësja e procesit të zgjerimit! E meriton të jetë anëtare e BE brenda dekadës**

■ **Ambasadorja e BE në Tiranë: Sa më pranë anëtarësimit ecni, aq më impenjativ bëhet! Vijoni punën me kapitujt**

■ **McAllister: Të fuqizohet pavarësia gjyqësore, më shumë rezultate ndaj korrupsionit**

■ **Zgjerimi i BE-së/ Rama: Mos i lini vendet kandidatë të luajnë me 'gangsterin rus' dhe 'lodrat kineze', Europa të mos na kujtojë vetëm kur ka kriza (VIDEO)**



Redaksia

28 Shtator, 11:00 | Përditësimi: 28 Shtator, 12:31

f Share Tweet



Një proces anëtarësimi që të kalojë nëpër disa faza paraprake duke i ofruar vendeve kandidatë një qasje graduale në mekanizmat e Bashkimit Europian, nuk është më thjesht një ide. E propozuar si alternativë nga disa prej vendeve me peshë si Gjermania e Franca, ajo është bërë pjesë e një dokumenti dhe të Komisionit Europian për rishikimin e zgjerimit.



"Europa duhet të gjejë atë momenti ne Helmut Kholn-it të thotë, hajdeni të gjithë rreth kësaj tavoline, të gjithë dhe pastaj se çfarë merr secili prej asaj tavoline kjo varet plotësisht nga merita, hap një kapitull dhe mbyll dhe për atë kapitull ti je plotësisht anëtar", tha Rama.

Në Konferencën Ndërparlamentare, të organizuar në Tiranë nga Kuvendi, kreu i qeverisë e quajti dështim për Europën, jo për vendet kandidatë nëse ato nuk anëtarësohen.



LEXO EDHE:

Arresti ndaj Hysenit/ Bardhi-Ramës: Nuk dhe llogari, pse e vendose në krye të SHISH?



"Dhe nëse Europa do të lërë në baltë Ballkanin Perëndimor atëherë nuk do të jetë një dështim i thjeshtë për Europën por do të jetë dështimi, ai më madhori", tha Rama.

Duke vlerësuar Shqipërinë për punë në bërë deri tani, kreu i Komisionit të Jashtëm të Parlamentit Europian David McAllister tha se ka ende punë përpara.



"Tashmë sfida që qëndron përpara është forcimi i pavarësisë së Gjyqësorit, arritja e rezultateve të qëndrueshme në luftën kundër korrupsionit dhe garantimi që institucionet publike t'u shërbejnë qytetarëve në mënyrë efektive", tha ai.

Edhe Raportuesi për Shqipërinë në PE, Andres Shider u shpreh optimist me objektivin e vendit tonë për një anëtarësim në këtë dekadë!



"Nuk është çështje vetëm të hapen kapitujt, ato duhen mbyllur por pastaj vjen edhe zbatimi që ka ndikimi i këtyre kapitujve. Prandaj, jemi në atë fazën fundit, Shqipëria duhet të mbyllë

edhe ato kapituj, ka kohë plotësisht për ta bërë atë gjë dhe pastaj mund të mendojmë edhe atë që Shqipëria meriton të jetë anëtare e re e BE përpara fundit të kësaj dekade.”

Thuajse në të njëjtën linjë dhe ambasadorja e re e BE-së në Tiranë Sofia Moreira de Sousa.




“BE ka njohur ecurinë në fusha të ndryshme, reforma në drejtësi ka shndërruar panoramën institucionale të gjyqësorit. Krijimi dhe fuqizimi i institucioneve të pavarura gjyqësore. Sa më pranë ecni me anëtarësimin, aq më impenjativ bëhet procesi. Sepse miratimi i legjislacionit është vetëm pjesë e procesit. Zbatimi është aspekti i pazëvendësueshëm”, tha ambasadorja.

Synimi i Shqipërisë është përfundimi i bisedimeve brenda vitit 2027 dhe anëtarësimi brenda kësaj dekade. Dhe për kreun e parlamentit Niko Peleshi, ky mbetet një objektiv strategjik i vendit.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 11:45

Integrimi/ Kryetari i Komisionit të Jashtëm në PE, McAllister: Shqipëria ka bërë përparim, të fuqizohet pavarësia gjyqësore, më shumë rezultate ndaj korrupsionit (VIDEO)



Kryetari i Komisionit të Jashtëm në Parlamentin Europian, David McAllister, vlerësoi përparimin e Shqipërisë në procesin e integritetit në BE, duke veçuar hapjen e të gjashtë grupkapitujve dhe mbylljen e tre kapitujve. Përmes një videomesazhi drejtuar Konferencës Ndërparlamentare të organizuar në Tiranë, ai theksoi se tashmë vendi duhet të fuqizojë pavarësinë e gjyqësorit dhe të tregojë më shumë rezultate në luftën kundër korrupsionit.



“Shqipëria dhe Mali i Zi kanë bërë shumë progres. Presidenti i Unionit përmendi prosperitetin, pra begatinë, sigurinë dhe demokracinë dhe i vendosi në qendër të programit të BE-së dhe zgjerimi kontribuon në të treja këto elemente, të treja këto shtylla, i afroh ekonomitë me njëra-tjetrën, i forcon institucionet demokratike dhe ndihmon që të kemi qëndrueshmëri afatgjatë në kontinentin tonë. Sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës e ka përforcuar se sa rëndësi ka zgjerimi i BE-së dhe të lësh Ballkanin Perëndimor në një pasiguri kaq të gjatë, me mbështetje të vogël për reformat dhe në këtë situatë kjo krijon mundësi që edhe palët e treta të zgjerojnë ndikimin e vet negativ aty.

Bashkimi Evropian duhet t'i çojë përpara negociatat. Sa herë përmbushen kushtet, vendet që bëjnë reforma do ta kenë mundësinë që të kenë besim tek BE-ja, që BE ta mbajë angazhimin që ka ndërmarrë. Shqipëria i ka hapur të gjithë grupkapitujt, të gjashtë grupkapitujt e negociatave. Në maj ka kapur ato standardet e ndërmjetme. Në korrik i ka mbyllur tre kapituj në lidhje me shkencën, studimet, edukimin dhe kulturën dhe me marrëdhëniet me jashtë. Këto arritje pasqyrojnë një punë shumë të madhe të bërë nga qeveria, nga deputetët dhe nga shumë prej nesh që janë të angazhuar për ta parë të ardhmen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. I duhet njohur kjo gjë Shqipërisë, i duhet vlerësuar. Detyra tani është që të fuqizohet pavarësia gjyqësore, të kemi më shumë rezultate ndaj korrupsionit dhe të sigurohemi që institucionet publike t'i shërbejnë mirë qytetarëve të vetë. Ju nxis që këto reforma t'i ndiqni me po atë vendosmëri.


Mali i Zi është vendi që ka ecur mjaft përpara në procesin e anëtarësimit. I ka hapur të tre të 33 kapitujt dhe ka mbyllur përkohësisht 18 prej tyre. Dhe duke e përfunduar ky proces, çohet një sinjal shumë i fortë në Ballkanin Perëndimor, sinjal që tregon që anëtarësia në BE është e arritshme. Axhenda e këtij programi në Tiranë i jep vëmendje shumë të posaçme rolit të kuvendeve, sepse si deputetët ne miratojmë legjislacionin e nevojshëm për anëtarësi. Ne i kërkojmë llogari qeverive dhe sigurohemi që angazhimet të zbatohen. Ne gjithashtu shqetësimet e qytetarëve i bëjmë pjesë të këtij procesi”, tha ai.

Sl.E./Shqiptarja.com

[f Share](#)

Ora 11:30

Ambasadorja e BE në Tiranë: Sa më pranë anëtarësimit ecni, aq më impenjativ bëhet! Vijoni punën me kapitujt, arritjet janë treguesi (VIDEO)





Procesi i anëtarësimit bëhet gjithnjë e më kërkuar sa më pranë tij të jetë Shqipëria, tha ambasadorja e BE në Tiranë, Sofia Moreira de Sousa. Ajo theksoi vazhdimisht gjatë fjalës së saj në Konferencën Ndërparlamentare se efekti i reformave duhet të jetë i prekshëm nga qytetarët dhe të ketë fokus qasjen dhe gjithëpërfshirjen.



"E ardhmja europiane e Shqipërisë po bëhet gjithnjë e më e prekshme. Anëtarësimi jo vetëm që përgatit Shqipërinë për anëtarësimin e ardhshëm në BE, por ndihmon qytetarët shqiptarë që të ndiejnë efektin shndërrues që ai sjell. Sa më pranë ecni me anëtarësimin, aq më impenjativ bëhet procesi sepse miratimi i legjislacionit është vetëm pjesë, sepse zbatimi është i pazvëndësueshëm. Faza ku gjendet Shqipëria do të kërkojë që institucionet të kërkojnë në mënyrë të përhershme të pavarur. Çfarëdo lloj vlerësimi për gjendjen ku ekziston një demokraci nuk bëhet vetëm me zgjedhjet, por edhe si e luan rolin e vet Kuvendi, transparenca, vendimmarrja dhe debati politik. Zëri i qytetarëve ofron gjithashtu hapësirën ku mund të shprehen dhe debatohen vendimet politike. Kalendar i ambicioz nuk mund të vijë në dëm të cilësisë, mbikëqyrjes parlamentare dhe ndaj është kaq e rëndësishme qasja dhe gjithëpërfshirja. Anëtarësimi merr kuptim vetëm kur qytetarët kuptojnë çfarë do të thotë vërtet BE për jetën e tyre të përditshme", tha Moreira de Sousa.

Mesazhi është i qartë, tha ambasadorja, Shqipëria të vijojë me negociatat dhe BE e mbështet, por gjithçka varet nga arritjet konkrete. Destinacioni është Europa e bashkuar dhe kontributi i Shqipërisë në BE.




"Ambicia për të mbyllur negociatat deri në 2027 është impenjative, kërkon angazhim të vazhdueshëm. BE mbetet mbështetës kryesor, por besueshmëria e kësaj ambicieje varet tek arritjet. Mesazhi është i qartë: vazhdoni me këtë që po bëni. Rugëtimi evropian e ka ndryshuar Shqipërinë në shumë aspekte. Detyra që mbetet është që shndërrimi të vazhdojë, përfitimet e reformave të ndihen nga qytetarët. Destinacioni është më shumë se anëtarësim, por një Europë më e bashkuar dhe rezistente ndaj kërcënimeve të së ardhmes, si dhe një Shqipëri që është e gatshme të kontribuojë në BE", përfundoi ambasadorja.

P.J/Shqiptarja.com

f Share

Ora 11:12

Integrimi në BE, raportuesi Schieder: Shqipëria është pararendësja e procesit të zgjerimit! E meriton të jetë anëtare e re brenda dekadës (VIDEO)



Shqipëria është pararendëse e procesit të zgjerimit, tha raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian, Andreas Schieder. Në Konferencën Ndërparlamentare, ai shprehu dëshirën për të dhënë kontributin e tij në zgjerimin e Bashkimit Europian.



"Zgjerimi i BE-së nuk është vetëm projekt i së ardhmes, është diçka që e meriton gjithë kontinenti dhe ajo që ëndërronim në 1989 dhe dua të jap edhe unë kontributin tim për të finalizuar këtë moment historik. Mbase ka shkuar pak gjatë, por ka një mundësi më të mirë. Shqipëria është pararendësja e procesit të zgjerimit dhe për mua është funksion i PE që t'i shohë të gjitha hollësitë nga një pikëpamje e politikave parlamentare të BE-së", tha Schieder.

Ndërsa përmbodhi arritjet e Shqipërisë gjatë negociatave, Schieder tha se reformat duhet të reflektojnë ndryshimin në shoqëri. Besimplotë tha se vendi mund të mbyllë ende disa kapituj dhe të realizojë ambicien e anëtarësimit brenda dekadës 2030.



"Pas gjithë këtyre negociatave, kanë dalë shumë hollësi, por tani ndodhemi në fazën e fundit




te gares. Ka ende disa kapituj qe duhen mbyllur, Shqiperia ka qene mjaft veprorre. S'eshte vetem hapja e kapitujve, duhet edhe mbyllja. Pastaj vjen ndikimi qe ka zbatim i këtyre kapitujve dhe këto reforma të ndihen në shoqëri. Shqipëria mundet të mbyllë edhe disa kapituj, e meriton të jetë anëtare e re brenda kësaj dekade", tha raportuesi.

P.J/Shqiptarja.com

f Share

Ora 11:02

Zgjerimi i BE-së/ Rama: Mos i lini vendet kandidate të luajnë me 'gangsterin rus' dhe 'lodrat kineze', Europa të mos na kujtojë vetëm kur ka kriza (VIDEO)



Kryeministri [Edi Rama](#) kërkoi që vendimet politike për zgjerimin e Bashkimit European të mos lihen për në momentin e fundit, ndërsa procesi për secilin vend të vijojë më pas mbi bazën e meritës. Rama tha se Europa duhet t'i mbajë vendet kandidate rreth "tavolinës" dhe larg ndikimit të Rusisë dhe Kinës.



"Çfarë duhet të ndryshojë dhe çfarë mund t'i lehtësojë ata persona që ngurrojnë, është që vendimet politike të mos lihen për momentin e fundit, por të merren tani dhe pastaj, në fund, të lihen proceset në bazë të meritës që çdo vend ka. Ka një kohë, shtatë fëmijë ka Ursula dhe BE-ja ka shtatë kandidatë. Fëmijët e Ursulës nuk u rritën në lagje, ata u rritën rreth tavolinës. Ajo nuk i tha vajzës: 'Shko dhe kalo ca kohë me gangsterin rus te cepi, se mami është pak e zënë'. Nuk i tha djalit: 'Shko e luaj me ca lodra kineze, sepse tavolinën tani e përdorin të rriturit'. Nuk duhet të kujtojmë se jemi në Europë sa herë ka një sulm apo kur ka ndonjë pandemi dhe gjendemi rreth kësaj tavoline. Apo kur vjen ndonjë valë emigracioni të paligjshëm në Europë; në ato momente nevojitemi edhe ne, sepse rruga e emigracionit kalon nga këtu. Shumë e thjeshtë është: hajdeni, bëjeni", tha Rama.

Sl.E/Shqiptarja.com

f Share

P.J/Shqiptarja.com

TAG: konferenca nderparlamentare edi rama

Sa e vlerësoni këtë artikull?



1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

26 Shtator, 18:15

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë, Rama lë Pallatin e Brigadave (VIDEO)

28 Shtator, 10:24



Dy kryeministra në Amerikë



Thoma Gëllçi

28 Shtator, 10:01



Magjistratët refuzojnë tryezën e Ramës për pagat: Dialog pas vendimit të Kushtetueses! Kryeministria anulon

takimin: Nga nesër, nis
hartimi i skemës së re

28 Shtator, 09:19



**Integrimi në BE/ Sot
Konferenca
ndërparlamentare, i
pranishëm Rama, Peleshi
dhe Schieder! Në fokus
zgjerimi i BE dhe**



**Ish-kreu i SHISH nën
arrest për nxjerrje të
sekretit shtetëror, Begaj
mbledh Këshillin e
Sigurimit për 1 orë e
gjysmë, merr pjesë edhe**



**Ylli Pata: Iluzioni i
pushtetit që vjen nga lart**



Ylli Pata

27 Shtator, 20:58

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.